



# Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

**Parimi: Viktimat dhe të mbijetuarit/at duhet të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve dhe diskursit publik të BmK**

**Studim i rastit**



## Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërliken me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit<sup>1</sup>. Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kryesore që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Viktimat dhe të mbijetuarit/at duhet të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve dhe diskursit publik të BmK”.

### Viktimat dhe të mbijetuarit/at duhet të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve dhe diskursit publik të BmK

Të gjitha nismat e Ballafaqimit me të Kaluarën, formale dhe joformale, jo vetëm që duhet t’i përfshijnë viktimat dhe të mbijetuarit/at, por duhet t’i vendosin në qendër të procesit. Kontributi dhe fuqizimi i viktimave dhe të mbijetuarve/ave është vendimtar në të gjitha aktivitetet e ballafaqimit me të kaluarën. Pa pjesëmarrjen e tyre, proceset e ballafaqimit me të kaluarën nuk mund të jenë plotësisht të suksesshme.

## Hyrje

Viktima ose i dëmtuari është “personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale<sup>2</sup>”, që në parimet të cilat po i promovojmë ne paraqitet si viktima direkte e veprave penale të kryera gjatë konfliktit të armatosur.

Qasja e përqëndruar tek viktima përkufizohet si fokusim sistematik në nevojat dhe shqetësimet e një viktime për të siguruar ofrimin e ndjeshëm të shërbimeve, në një mënyrë jo paragjykuese. Kjo qasje synon të minimizojë ritraumatizimin e viktimave, e që lidhet me procesin e drejtësisë penale, duke fuqizuar të mbijetuarit si pjesëmarrës të angazhuar në proces dhe duke u ofruar atyre një mundësi për të parë kriminelët të sillen para drejtësisë. Aplikimi i kësaj qasjeje në hetimet penale është primare dhe fundamentale në një proces të suksesshëm penal<sup>3</sup>.

Udhëzimi i sekretarit gjeneral me titull “Qasja e Kombeve të Bashkuara në Drejtësi Tranzicionale”, në një nga

<sup>1</sup> Principi ALB (yih-r-ks.org)

<sup>2</sup> Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës, Neni 19, Faqe 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

<sup>3</sup> Office for victims of crime – Training and Technical Assistance Center, Office of Justice Programs, <https://www.ovcttac.gov/taskforceguide/eguide/1-understanding-human-trafficking/13-victim-centered-approach/n>



parimet e saj thekson rëndësinë se duhet të sigurohet që viktimat të jenë në qendër të hartimit dhe implementimit të proceseve dhe mekanizmave të drejtësisë tranzicionale. Duke i vendosur viktimat në qendër të këtyre aktiviteteve, gjithashtu kërkohet që të sigurohet respektim i plotë i të drejtave të viktimave, e të garantohet siguria dhe dinjiteti i viktimave<sup>4</sup>.

Mungesa e programeve të zhvillimit dhe përfshirjes për nevojat specifike të familjeve të viktimave, rezulton në dhunë strukturore të ushtruar mbi viktimat, të mbijetuarit dhe anëtarët e familjeve të personave të zhdukur, e të cilat rrjedhimisht pengojnë procesin e riintegrit të tyre në shoqëri<sup>5</sup>.

Të gjitha viktimat duhet të jenë në qendër të të gjitha nismave për ballafaqim me të kaluarën. Sepse me kontributin e tyre, më së miri do të mund të vihet themeli i secilës prej këtyre nismave dhe që kjo do t'iu ndihmonte atyre që të merrnin drejtësi, të gjindet dhe dëgjohet e vërteta për vuajtjet e tyre si dhe do kompensoheshin në mënyrë më të drejtë dhe efikase.

---

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), në maj të vitit 2019 ka hapur ekspozitën me titull “Na ishte një herë që kurrë mos qoftë”, ekspozitë kjo e realizuar në kujtim të 1133 fëmijëve të vrarë/të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Për realizimin e të njëjtës, FDHK ka kontaktuar me prindërit dhe familjarët e viktimave dhe të mbijetuarve, duke i përfshirë në mënyrë direkte në jetësimin e ekspozitës. Ata kanë ndarë historitë e fëmijëve të tyre me FDHK dhe gjithashtu kanë dhënë gjësendet personale të fëmijëve, në mënyrë që ata të kujtohen dhe kujtimi për ta të mos shuhet kurrë, por që në të njëjtën kohë kjo ekspozitë është realizuar për t'a kërkuar të vërtetën. Kjo ekspozitë tanimë mund të shihet edhe në mënyrë virtuale<sup>6</sup>.

Në lidhje me ekspozitën është botuar edhe një katalog, me qëllim të dokumentimit të saj. Në të janë përfshirë të dhënat e fëmijëve të cilët janë vrarë apo edhe janë zhdukur gjatë periudhës së viteve 1998-2000. Gjithashtu një pjesë është e dedikuar për gjësendet të cilat i përkisnin disa prej atyre fëmijëve<sup>7</sup>, të cilat janë dhënë nga prindërit e tyre, e të cilët kanë dashur që ato sende të mbesin pjesë të ekspozitës dhe të mos iu kthehen mbrapsht atyre. Në këtë formë është siguar që viktimat dhe të mbijetuarit në mënyrë direkte të jenë pjesë e iniciativave që ndërlihen me humbjet e tyre gjatë luftës, e që në këtë mënyrë ata të marrin trajtim të dinjitetshëm nga institucionet dhe nga shoqëria.

---

Në qershor të vitit 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës në një nga mbledhjet e saj, kishte marrë vendim për themelimin e Grupit Punues Ndërmintor për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GP BmKP). Ky grup punues ishte themeluar me qëllim që të hartojë Strategjinë Nacionale për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin.

Si shembull pozitiv të cilin e paraqet vendimi për themelimin e këtij Grupi Punues, ishte që në kuadër të standardeve të cilat ishin të përcaktuara në këtë dokument, thuhej se Grupi duhet të plotësonte disa kritere me qëllim që të sigurohet procesi i ballafaqimit me të kaluarën dhe pajtimin. Pika e parë në kuadër të këtyre kritereve ishte përfshirja, sipas të cilës do të duhej të diskutohen dhe merren parasysh pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara relevante, përfshirë ato të pjesëtarëve të komuniteteve në Kosovë si dhe viktimave të konfliktit. Sipas kësaj pike thuhej se duhet të sigurohet pjesëmarrja e viktimave të konfliktit në këtë Grup Punues si dhe në procesin e Ballafaqimit me të Kaluarën dhe Pajtimin.

---

<sup>4</sup> Guidance note of the Secretary General, United Nations Approach to Transitional Justice, Page 2

<sup>5</sup> QKRMT, Doracak për Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën, Faqe 7

<sup>6</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Ekspozita “Na ishte një herë që kurrë mos qoftë”, <https://hlc-kosovo.org/themes/fdh/assets/360/ekspozita.html>

<sup>7</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Ekspozita “Na ishte një herë që kurrë mos qoftë”, Katalogu, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Katalogu%20digjital/HLC-BOOK-NOV26112020-AL.pdf>



Si plan i veprimit të këtij Grupi Punues ishte që pas themelimit të tij, i njëjti të miratojë planin e veprimit për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale<sup>8</sup>.

“Në vitin 2014, GP BmKP, ka zhvilluar dhe miratuar planin e punës për hartimin e po kësaj Strategjie Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë 2015-2017”. Në kuadër të këtij grupi punues ishin themeluar katër nëngrupe, përkatësisht nëngrupi i të drejtës për të ditur të vërtetën, nëngrupi i të drejtës për drejtësi, i reparacioneve dhe nëngrupi për garancitë për mospërsëritje. Në kuadër të këtyre nëngrupeve të specifikuara, ato kanë pasur në plan të punës që të përfshihen konsultimet me palët e interesuara, e gjithashtu kanë krijuar edhe një listë të organizatave të viktimave, me qëllim të konsultimit me to, në mënyrë që t’i kontribuojnë Strategjisë Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale. Këto konsultime ishin menduar që të sigurojnë që Strategjia Kombëtare plotëson nevojat reale të kategorive të viktimave dhe të shoqërisë në përgjithësi dhe që të krijojë mundësi për të hulumtuar se çfarë mund të ofroj shteti në mënyrë që kjo të jetë e pranueshme nga viktimat dhe nga shoqëria<sup>9</sup>.

Për fat të keq Grupi Punues për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin ka pushuar së funksionuari para se të fillojë me konsultime publike.

---

Qeveria Kurti 2 ka ndërmarrë disa nisma për themelimin e mekanizmave dhe hartimin e dokumenteve që kanë të bëjnë me drejtësinë tranzicionale. Një ndër to është hartimi i Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale. Është krijuar Grupi Punues për hartimin e kësaj strategjie, ku në takimin e parë në gusht të vitit 2021, ishte diskutuar që të bashkohen të gjitha nismat të cilat i përkasin ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësisë tranzicionale.

Ministrja e Drejtësisë Albulena Haxhiu e kishte theksuar rëndësinë e viktimave në hartimin e një strategjie të tillë. Sipas saj do të duhej të përkushtohet “në hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse, me fokus viktimat dhe duke pasur ndjeshmëri karshi aspektit gjinor<sup>10</sup>”. Ajo gjithashtu kishte kërkuar “nga grupi punues që hartimi i Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale të bëhet në konsultim të vazhdueshëm me qytetarët që janë prekur nga lufta, në mënyrë që kjo strategji të pasqyrojë më së miri përvojat, nevojat dhe të drejtat e viktimave<sup>11</sup>”. Koalicioni jo formal për Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën e përshëndet vullnetin e ministres Haxhiu për përfshirjen e komunitetit të viktimave në kuadër të kësaj nisme, vullnet ky i cili është në përputhje me parimin të cilin po e shtjellojmë.

---

Nisma e fundit e cila është ndërmarrë nga ana e institucioneve shtetërore është hartimi i projektligjit me të cilin synohet që të themelohet Instituti për Dokumentimin e Krimeve të Luftës në Kosovë. Edhe pse një institut i tillë ka ekzistuar më parë, i cili ishte themeluar në vitin 2011, i njëjti ishte shuar më 2018 me pretekstin se nuk kishte arritur që t’a përmbushte mandatin e tij<sup>12</sup>.

Për këtë arsye më 13 maj 2020, ministrja e drejtësisë Albulena Haxhiu kishte marrë vendim për formimin e ekipit punues për përgaditjen e analizës për themelimin e Institutit për hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë<sup>13</sup>. Në këtë grup punues të formuar nga Ministria e Drejtësisë, përveç zyrtarëve përkatës të politikave dhe përfaqësuesve politik, kishte pjesëmarrës edhe të shoqërisë civile, ekspertë vendorë, konsulentë

---

<sup>8</sup> Kryeministri.rks-gov.net, Vendim për themelimin e Grupit Punues Ndërmësor për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin, Nr. 03/77, 04.06.2012, Faqe 3-8, [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_77-te\\_te\\_Qeverise\\_se\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2012.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_77-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2012.pdf)

<sup>9</sup> Ballafaqimi me të Kaluarën dhe Pajtim në Kosovë, Një përmbledhje e institucioneve dhe iniciativave, Dokument Punues, 2017, Faqe, 46, Prishtinë, Kosovë

<sup>10</sup> Zyra e Kryeministrit, 18.08.2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/kryeministri-kurti-ne-takimin-e-grupit-punues-strategjia-per-drejtësinë-tranzicionale-duhet-te-bashkohen-te-gjitha-nismat-per-adresim-te-se-kaluares/>

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Balkan Insight, 20.05.2020, Kosova provon të themelojë sërish Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, <https://balkaninsight.com/sq/2020/05/20/kosova-provon-te-themeloje-serish-institutin-per-hulumtimin-e-krimeve-te-luftes/>

<sup>13</sup> Facebook Post, Albulena Haxhiu, 13.05.2020, <https://www.facebook.com/hapeporten/posts/365828557757540>



dhe qytetarë të cilët vullnetarisht kanë dokumentuar krimet e luftës gjatë këtyre 20 viteve të fundit<sup>14</sup>. Por sikurse në nismat të cilat i kemi cekur më lartë, edhe kjo nismë për themelimin e Institutit do të duhej të kishte përfaqësues nga komuniteti i viktimave dhe personave të prekur nga lufta, me qëllimin kryesor që në këtë mënyrë të pasqyrohen përvojat dhe kërkesat e viktimave në planin e punës të Institutit.

KOMRA është komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në ish Jugosllavi që nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor të vitit 2001. KOMRA është një komision ndërqeveritar i përbërë nga shtetet e dala nga territori i ish-Jugosllavisë. Ky trup jo-gjyqësor do të hulumtoj akuzat për të gjitha krimet e luftës dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut në lidhje me luftën, do të regjistroj të gjitha viktimat e luftës dhe viktimat e krimeve të lidhura me luftën, do të mbledhë informacione në lidhje me kampet dhe vende të tjera të përqendrimit të detyruar<sup>15</sup>.

KOMRA gjatë hapave të saj të zhvillimit ka realizuar konsultime publike me akterë të ndryshëm të cilët ishin relevant me mandatin të cilin kishte ajo. KOMRA kishte përfshirë një mori konsultimesh me viktimat e luftës, nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, duke përfshirë diskutimet e shumta me viktimat dhe të mbijetuarit e luftës në Kosovë.

Më datë 4 tetor 2008 ishin mbajtur konsultimet e para me familjet e personave të zhdukur, familjet e viktimave, shoqatat e viktimave, e gjithashtu edhe pjesëmarrës të tjerë, e panelistë nga Fondi për të Drejtën Humanitare Serbi, organizata Documenta në Kroaci dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë. Në këtë takim të mbajtur ishin diskutuar përvojat e të pranishëmve, duke i dhënë hapsirë të veçantë specifikisht viktimave dhe të prekurve të luftës në Kosovë. Ata kishin shpalosur përvojat e tyre dhe kanë diskutuar në lidhje me mënyrat se si do të mund të ndihmonte iniciativa për krijimin e këtij komisioni, në gjetjen e të vërtetës dhe ofrimin e ndihmës karshi të mbijetuarve dhe familjarëve të viktimave të luftës në Kosovë<sup>16</sup>.

Konsultimi i rradhës i kësaj iniciative për KOMRA ishte realizuar me 22 pjesëmarrës, të cilët kishin përfaqësuar kryesisht sektorin joqeveritar dhe shoqatat e viktimave, më 9 maj 2009<sup>17</sup>.

Gjithashtu KOMRA kishte realizuar konsultime edhe me gratë, viktimat e luftës, të cilat vinin nga Rahoveci, Hoqa e Madhe dhe Krusha e madhe, e të cilat ishin të përkatësive të ndryshme etnike, nga to shqiptare, serbe dhe rome<sup>18</sup>. Përpos grave viktimat, konsultimi i fundit i cili ishte realizuar kishte qenë me qëllim të draftimit të Statutit të KOMRA-s, ishin ftuar viktimat dhe rreth 70 anëtarë të familjeve të viktimave, në mënyrë që të kontribuonin në draftimin e këtij Statuti<sup>19</sup>.

Iniciativa për themelimin e KOMRA është një shembull se si do të duhej të përfshiheshin viktimat dhe të mbijetuarit e luftës në Kosovë në të gjitha nismat të cilat kanë të bëjnë me Ballafaqimin me të Kaluarën. Prandaj të gjitha iniciativat të cilat tanimë janë duke funksionuar por edhe ato të cilat do të themelohen nga tash e tutje, duhet që t'u japin hapsirë të veçantë viktimave dhe të mbijetuarve të luftës, në mënyrë që përjetimet e tyre të mirren për bazë dhe të përdoren narrativa të sakta të luftës.

<sup>14</sup> Indeks Online, 07.06.2021, <https://indeksonline.net/sot-mbahet-takimi-i-pare-i-grupit-punues-i-institutit-per-krimet-e-kryera-gjate-luftes/>

<sup>15</sup> Recom.link, Rrjeti i Pajtitimit KOMRA, <https://www.recom.link/sq/sta-je-rekom/>

<sup>16</sup> RECOM, FDHK, Konsultimet me shoqatat e viktimave Iniciativat dhe instrumentet për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës në ish Jugosllavi, 04.10.2008, <https://www.recom.link/wp-content/uploads/2008/10/kopje-e-shkruar.pdf>

<sup>17</sup> KOMRA, 09.05.2009, Konsultimet 2009, Kosova, OJQ, Shoqatat e viktimave, <https://www.recom.link/sq/konsultat-kombetare-me-shoqatat-e-viktimave-dhe-shogerine-civile-lidhur-me-iniciativen-komra/>

<sup>18</sup> KOMRA, 04.12.2010, Gratë viktimat e luftës Rahovec, Kosovë, <https://www.recom.link/sq/konsultime-me-gra-viktima/>

<sup>19</sup> KOMRA, 17.12.2010, Association of Victims – Prishtinë, Kosova, <https://www.recom.link/en/consultations-with-victims/>



## Rekomandime

Në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën<sup>20</sup>”, të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Përpos organizimit të konsultimeve me komunitetin e viktimave për çështjet që kanë të bëjnë me Ballafaqimin me të Kaluarën, institucionet duhet të përkujdesen që edhe në grupet punuese për draftimin e politikve apo legjislacionit të përfshijnë përfaqësues të komunitetit të viktimave.

*Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.*

---

<sup>20</sup> [Principi ALB \(yih-ks.org\)](http://PrincipiALB.org)

 [@dwpkosovo](https://www.facebook.com/dwpkosovo)

 [@dwpkosovo](https://www.instagram.com/dwpkosovo)

 [@dwpkosovo](https://twitter.com/dwpkosovo)

 [dwpkosovo](https://www.youtube.com/dwpkosovo)